

20111363013

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
LIGJIT PËR PUNËSIM TË PERSONAVE INVALIDË

Neni 1

Në Ligjin për punësim të personave invalidë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 44/2000, 16/2004, 62/2005, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 161/2008 dhe 99/2009), në nenin 16 paragrafi 5 ndryshohet si vijon:

"Këshilli Drejtues i Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë, miraton aktvendim për ndarjen e mjeteve nga Fondi i posaçëm në çdo 90 ditë."

Pas paragrafit 5 shtohen shtatëmbëdhjetë paragrafë të rinj 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21 dhe 22, si vijojnë:

"Nese Këshilli Drejtues i Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë nuk miraton aktvendim për ndarjen e mjeteve nga Fondi i posaçëm në afatin nga paragrafi 5 i këtij neni, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri ditësh pune nga kalimi i atij afati të parashtojë kërkesë në sekretarinë e kryetarit të Këshillit Drejtues të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë, për miratimin e aktvendimit për kërkesën e parashtruar.

Formen dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi 6 i këtij neni i përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale.

Me kërkesën për miratimin e aktvendimit për ndarjen e mjeteve nga Fondi i posaçëm, parashtruesi i kërkesës dergon edhe kopje të kërkesës nga paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni.

Kryetari i Këshillit Drejtues të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë obligohet që në afat prej pesë ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi 6 i këtij neni në sekretarinë e Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë, të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa për ndarjen e mjeteve nga Fondi i posaçëm pranohet ose refuzohet.

Nese kryetari i Këshillit Drejtues të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë nuk miraton Aktvendim në afat të paragrafit 9 të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Administrativ Shtetëror në afat prej pesë ditësh pune.

Inspektorati Administrativ Shtetëror obligohet që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi 10 i këtij neni të kryejë mbikëqyrje në Këshillin Drejtues të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë nëse është realizuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditësh pune nga dita e mbikëqyrjes së kryer ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

Inspektori i Inspektoratit Administrativ Shtetëror pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin miraton aktvendim me të cilin e detyron kryetarin e Këshillit Drejtues të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë që në afat prej dhjetë ditësh të vendosë për kërkesën e parashtruar, përkatësisht ta pranojë ose refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dergohet kopje e aktit me të cilin është vendosur për kërkesën e parashtruar.

Nese kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë nuk vendosin në afat të paragrafit 12 të këtij neni, inspektori do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të caktuar në Ligjin për inspeksion administrativ dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditësh pune në të cilin kryetari i Këshillit Drejtues të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë do të vendosë për kërkesën e parashtruar për çka në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dergohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri ditësh pune e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

Nese kryetari i Këshillit Drejtues të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë nuk vendos edhe në afatin plotësues nga paragrafi 13 i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditësh pune do të parashtojë kallëzim te prokurori publik dhe në atë afat e informon parashtruesin e kërkeses për masat e ndërmarra.

Nese inspektori nuk vepron sipas njoftimit nga paragrafi 12 i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pese ditësh pune ka të drejtë të parashtojë ankesë në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Administrativ Shtetëror. Nese drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Administrativ Shtetëror.

Drejtori i Inspektoratit Administrativ Shtetëror detyrohet që në afat prej tri ditësh pune ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi 15 i këtij neni dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar sipas njoftimit nga parashtruesi i kërkeses nga paragrafët 11 dhe 12 dhe/ose nuk parashtron kallezim në pajtim me nenet 13 dhe 14 të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Administrativ Shtetëror do të parashtojë kerkese për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin dhe do të caktojë afat plotësues prej pese ditësh pune në të cilin inspektori do të kryejë mbikeqyrje në Këshillin Drejtues të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditësh pune nga dita e mbikeqyrjes së kryer ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

Nese inspektori nuk vepron edhe në afatin plotësues nga paragrafi 16 i këtij neni drejtori i Inspektoratit Administrativ Shtetëror do të parashtojë kallëzim te prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditësh pune do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

Në rastin e paragrafit 17 të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Administrativ Shtetëror menjëherë, kurse më së voni në afat prej një ditë pune do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikeqyrjen menjëherë.

Në rastin e paragrafit 18 të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Administrativ Shtetëror në afat prej tri ditësh pune do ta informojë parashtruesin e kërkesës.

Nese drejtori i Inspektoratit Administrativ Shtetëror nuk vepron në pajtim me paragrafin 18 të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të parashtojë kallëzim te prokurori publik kompetent, në afat prej tetë ditësh pune.

Nese Kryetari i Këshillit Drejtues të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë nuk vendos në afatin nga paragrafi 14 i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngrit kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente".

Paragrafet 6 dhe 7 bëhen paragrafë 23 dhe 24.

Neni 2

Akti nënligjor i nga neni 1, paragrafi 7 të këtij ligji do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes së fuqi të këtij ligji.

Pas miratimit të aktit nënligjor nga paragrafi 1 i këtij neni ai menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej 24 orësh publikohet në ueb faqen e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale.

Neni 3

Ky ligj hynë në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".